



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 3213

NR. VENDIMI 2590

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTAR – KUJTIM VRANIÇI

Asistuar nga sekretare gjyqësore, znj.Marjana Xhamallati, në Tiranë, më datë 06.10.2021 në Tiranë, përfundoi së shqyrtoari çështjen penale, që i përket :

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori i çështjes, **z. Petrit Hysi.**

ME OBJEKT: Dërgimin në gjyq të çështjes penale Nr.2518 të vitit 2021, kundër :

TË PANDEHURIT: **Agron Bajraktari,** identifikuar me kartë identiteti me numër personal G20821059S, i biri i Latif dhe Xhevrije, i datëlindjes 21.08.1962, lindur në Maqëllarë të Rrethit Dibër dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga “Don Bosko”, banesë private Nr.179, me shtetësi dhe kombesi shqiptare, me arsim të mësëm, me gjëndje familjare i ve me dy fëmijë, me gjëndje gjyqësore i padënuar më parë, hetuar dhe gjykuar në gjëndje të lirë dhe mbajtës i numrit të telefonit celular 069 22 01 225, **mbrojtur me deklaram** në seancë gjyqësore nga avokatia **Antoneta Sevdari,** Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, me Nr.10407 Liçense dhe NIPTI M 01411034 T.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga Neni 248 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 331 të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi administroi provat në seance gjyqësore, shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi

konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilët kërkuan:

-Përfaqësuesi i Prokurorisë:

- Deklarimin fajtor të pandehurit **Agron Bajraktari**, akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga Neni 248 i K.Penal dhe dënimin e tij me **një vit burgim**.
- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, duke qenë se i procedua me gjykim të shkurtuar, të pandehurit ti ulet 1/3 e masës së dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **tetë muaj burgim**.
- Në aplikim të Nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Agron Bajraktari**, për një periudhë **kohe prej 16 muajsh**, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mos kryej veprë tjetër penale dhe gjatë kohës së provës i pandehuri duhet të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës.
- Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprahe dhe atë të gjykimi i ngarkohen të pandehurit.

-Mbrojtja e të pandehurit, Av. Antoneta Sevdari: Pushimin e çështjes për shtetasin Agron Bajraktari, për shkak se nuk ekzistojnë elemente për marrjen e personit në përgjegjësi penale dhe në bazë të Nenit 328/dh, personi nuk e ka kryer veprën penale. Por nëse gjykata nuk bindet me kërkimin tone, kërkojmë caktimin e një mase dënimi sa më ulët se ai i kërkuar nga prokurrori si dhe aplikimin e Nenit 59 të K.Penal.

-I pandehuri u shpreh: Dakort me avokaten,

V Ë R E N

Se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në respektim të parashikimeve të Nenit 331 të K.Pr.Penale, është paraqitur kërkesa me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale Nr.3476 të vitit 2021, në ngarkim të pandehurit Renaldo Dyrmishi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga Neni 291 i K.Penal, duke i bashkëlidhur kërkesës edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli përkatës. Aktet e mesipërme, rezultojnë se i janë komunikuar të pandehurit Renaldo Dyrmishi edhe në presence të mbrojtësit ligjor të tij.

Përpara shqyrtimit të kërkesës, Gjykata mori kryesisht në shqyrtim çështjen e juridiksionit gjyqësor penal dhe të kompetencës lëndore dhe tokësore në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi. Në bazë të Nenit 69, 74, 76 dhe 13/2 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata në çështjen objekt gjykimi vendosi të njoftojë palët për datën dhe orën e seancës paraprake të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të saj, në mënyrë që t'u japë mundësinë të njihen me të gjitha aktet e hetimit paraprak dhe të përgatisin pretendimet e tyre. Në çështjen objekt gjykimi rezultoi të mos ketë viktimë.

I pandehuri gjatë hetimeve paraprake nuk ka paraqitur kontestime, ndërsa në seancën paraprake, asistuar edhe nga mbrojtësi ligjor i tij, avokati Armando Daçi kërkoi gjykim të shkurtuar, konform Nenit 332/c pika 3 dhe 403 e vijues të K.Pr.Penale, duke e pranuar plotesisht akuzën në ngarkim të tij.

Gjykata pasi dëgjoi parashtrimin e prokurorit, pranoi kërkesën e të pandehurit Amarildo Saliu, të parashtruar nëpërmjet mbrojtësit ligjor të tij, në bazë të Nenit 332/dh gërma "c", e ndryshuar me Ligjin Nr. 41 të vitit 2021 dhe Nenin 405/6 të K.Pr.Penale, pasi çmon se çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, e zhvilloi gjykimin sipas kërkesave të këtij neni, pra duke u bazuar në gjendjen që janë aktet e procedimit penal Nr.2518 të vitit 2021, të cilat i janë bashkangjitur fashikullit të gjykimit.

Nga diskutimi gjyqësor i fakteve dhe rrethanave të çështjes, rezultoi e provuar se:

Më datë 10.04.2021, rreth orës 01.10, është konstatuar vjedhja e subjekti tregetar "Blendi" shpk, në rrugën dytesore Kashar-Tiranë. Autorët e vjedhjes pasi janë futur në ambientet e brendshme të ndërtesës së shoqërisë nëpërmjet njërës prej dritareve të saj dhe në zyrën e financës kanë vjedhur një shumë prej 700 mijë lekesh.

Shtetasi Besnik Zhapa pronar i biznesit "Blendi" sh.p.k, e cila tregeton pajisje Hidrosanitare, me vendndodhje në rrugën dytesore Kashar-Tiranë midis të tjerash kallzon se, në biznesin tim është i punësuar si roje prej shumë vitesh një person nga kompania "Leksi Security". Nga pamjet filmike konstatova se, rreth orës 00.58, të datës 10.04.2021, në ambientet e brendshme të biznesi pasi kanë kapërcyer gardhin rrethues janë futur tre persona. Këta persona pasi janë futur në ambientet e brendshme të biznesit kanë kontrolluar në disa ambiente të brendshme të tij janë futur në zyrën e financës ku mbaja xhiror ditore. Pasi kanë hapur një kasafortë kanë vjedhur shumën prej 700 mijë lekesh. Autorët e vjedhjes kanë vepruar në mënyrë të qetë pasi edhe roja ka qenë në kabinën e tij dhe sic duket edhe nga pamjet filmike nuk ka vepruar. Në momentin që autorët janë larguar nga biznesi, roja ka dalur nga kabina.

Theksoj se, megjithatë i ka parë autorët, roja e objektit nuk ka njoftuar as kompaninë e tij ku është i punësuar dhe as policinë e shtetit me pretendim se nuk kishte radio dhe se telefonin nuk e kishte rimbushur. Personat që kanë kryer vjedhjen ishin të veshur me veshje sportive dhe mbanin maska në pjesën e fytyrës. Të tre autorët e vjedhjes mbanin dorashka me ngjyrë të zeze në duar dhe një njëri prej tyre kishte në koke një kapele me dritë në pjesën e sipërme, si kapelet e minatoreve. Pasi kanë kryer vjedhjen duke qëndruar për disa minuta në biznes janë larguar perseri duke kapërcyer murin rrethues të biznesit.

Shtetasi Ledian Zhapa me detyren e menaxherit ne shoqerine "Blendi" shpk deklarone, me dt.10.04.2021, kam shkuar ne pune rreth ores 05.10. Jam takuar me rojen e objektit i cili me tha se rreth ores 01.00' kam pare nje person brenda ambjenteve te magazines te cilin e kishte ndjekur por ai i kishte ikur me vrap duke kapercyer murin rrethues. Po keshtu me tha se, dera e "showroom-it" te katit te dyte ishte e hapur.Pasi hapa zyren konstatova se, dritarja e saj ishte e shqyer dhe sirtaret dhe mobiljet e zyres ishin levizur si dhe ishte hapur nje kasaforte. Pyeta rojen e objektit se perse nuk kishte njoftuar policine dhe kompanine qe e ka punesuar dhe ai u pergjigj se nuk kishte leke ne telefon. Per sa konstatova njoftova pronarin e shoqerise i cili erdhi vete ne objekt.Me pas ne vendngjarje erdhen edhe organet policore.

Shtetasi Haxhi Sala, me detyren e drejtuesit teknik ne kompanine "Security Leksi" shpk deklarone se rreth ores 05.00 eshte njoftuar per nje vjedhje te ndodhur ne biznesin "Blendi" shpk ku roja ka qene punonjesi i kesaj kompanie sigurimi, shtetasi Agron Bajraktari.Ai shton se roja prej disa ditesh ka qene pa radio pasi ajo ka qene prishur.

Kurse i pandehuri Agron Bajraktari i ngarkuar me ruajtjen e objektit midis te tjerash deklarone se, me dt.09.04.2021 kam marre sherbimin e rojes rreth ores 15.00 dhe do tja dorezoja kolegut tim te nesermen e kesaj dite ne oren 07.00. Gjate sherbimit prej 16-ores kam qene i veshur me uniformen e sherbimit te kompanise "Leksi Security" ku jam i punesuar. Rreth ores 01.10 te nates ndersa isha ne vendroje degjova nje zhurme. Mora nje shkop per vetembrojtje dhe dola nga vendroja pasi pashe nje person me kapuc ne koke te cilin e pyeta se kushje por ai u largua me vrap duke kapercyer murin rrethues. E ndoqa disa metra por nuk arrita ta kapja. Mora aparatin telefonik per te njoftuar pronarin por telefoni m'u fik. Pasi kontrollova objektin pashe se dritarja e deges se finances dhe dera kryesore e objektit ishte e hapur dhe e demtuar. Kam per te thene se aparatin telefonik ma kane blere femijet por une nuk di ta perdore mire. Ne keto rrethana nuk munda te njoftoj as kompanine dhe as policine.Ne oren 05.10' kur ne pune ka ardhur punonjesi i shoqerise me emrin Ledio e vura ne dijeni te ngjarjes.Me nje detyre te tille punoj prej rreth dy muajsh.

Me cilesine e proves me dokumente eshte administruar nje CD-i me pamjet filmike te biznesit "Blendi" shpk. Nga pamjet filmike shihet se, autoret e vjedhjes jane tre persona te maskuar me kapuc ne koke dhe doreza ne duar, te veshur me rroba me ngjyre te zeze.Njeri prej tyre mban ne dore nje leve. Pasi shtyn me duar nje dritare, njeri prej tyre futet brenda. Pasi kryejne vjedhjen te tre autoret largohen duke kapercyer murin rrethues.

Bazuar ne Ligjin Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", ne nenin 27 te tij percaktohen detyrat e punonjesit te sherbimit te rojes ku midis te tjerash theksohet.

- a) Te kryej detyrat e percaktuara ne kete ligj e ne aktet nenligjore si dhe detyrat e dhena nga drejtuesi teknik.
- b) Te zbatoje me korrektesi detyrat per ruajtjen e objektit dhe te mbaje lidhje te vazhdueshme me drejtuesin teknik.

I pandehuri Agron Bajraktari, sipas dokumentit "Çertifikate" Nr.2558, dt.13.12.2020, eshte

certifikuar si punonjes i sherbimit SH.P.S.F-se per nje periudhe kohore kater vjecare. Nder detyrat e tij, te theksuara keto edhe ne Çertifikate midis te tjerash ka:

- Te njoftoje menjehere policine e shtetit per veprat penale te ndodhura ne objektin qe ruan,
- Te ndaloje personat qe pergatiten te kryejne ose dyshohen se kane kryer nje veper penale ne objekt ose qe kane lidhje me kete objekt.

Ne rrethanat e mesiperme i pandehuri Agron Bajraktari sikurse rezulton edhe nga pamjet filmike te sekuestruara nuk e ka kryer me korrektesi detyren e tij te rojes. Ai ndonese i ka pare autoret e vjedhjes duke u futur ne objekt nuk ka ndermarre asnje veprim per ti penguar ata por qendron ne vendroje pa levizur. Edhe pas kryerjes se vjedhjes autoret largohen pa u shqetesuar prej andej dhe vetem pasi autoret largohen nga objekti ai leviz nga vendroja/kabina e megjithe kete nuk njofton as sherbimin e tij te kompanise ku eshte i punesuar dhe as policine e shtetit.

Ne keto rrethana i pandehuri Agron Bajraktari duke moskryer me dashje veprime ne kundershtrim me ligjin qe perben mospermbushje te rregullt te detyres nga ana e tij si punonjes i sherbimit privat te ruajtjes dhe sigurise publike dhe demtuar interesat e ligjshme te personit juridik/subjektit "Blendi" sh.p.k ka konsumuar elementet e vepres penale "Shperdorimi i detyres" te parashikuar nga Neni 248 i K.Penal.

Mbi bazën e këtyre fakteve te parashtruara sa me siper, nga përfaqësuesi i organit të prokurorisë u kërkua deklarimi fajtor i të pandehurit Agron Bajraktari, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga Neni 248 i K.Penal, **dhe dënimin e tij si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.**

Kurse i pandehuri Agron Bajraktari nëpermjet mbrojtëses lihjore të tij, kërkoi pushimin e çështjes per shtetasin Agron Bajraktari, per shkak se nuk ekzistojne elemente per marrjen e personit në përgjegjësi penale dhe ne baze te Nenit 328/dh, personi nuk e ka kryer veprën penale. Por nese gjykata nuk bindet me kërkimin tone, kërkojme caktimin e nje mase denimi sa me ulët se ai i kerkuar nga prokurroi si dhe aplikimin e Nenit 59 të K.Penal.

Vlerësimi i Gjykatës.

Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: **a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive.** Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në

çështjen konkrete, Gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet.

Në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit Agron Bajraktari, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga Neni 248 i K.Penal, gjykata konstaton se i pandehuri i ka konsumuar elementët e figurës së kësaj vepre penale.

Në këto rrethana, të ndodhur përpara faktit të parashtruar më sipër, pretendimeve dhe provave të administruara në gjykim, Gjykata konkludon se në veprimet e të pandehurit Agron Bajraktari, janë të pranishëm të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga Neni 248 i K.Penal

Këto fakte të paligjshme për të cilat akuzohet i pandehuri Agron Bajraktari, u provuan plotësisht me një sërë provash shkresore, të cilat u çmuan nga ana e gjykatës në harmoni me njëra tjetrën, pra ne teresi aktet e procedimit penal Nr.2518 të vitit 2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Persa i perket cilësimit juridik të faktit penal.

Gjykata duke u nisur nga sa me sipër, pavaresisht pretendimeve të avokates çmon se rezultojnë e provuar se i pandehuri Agron Bajraktari ka konsumuar plotësisht veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, prandaj gjykata çmon se ajo duhet deklaruar fajtor për sa akuzohet.

Referuar Nenit 248 i Kodit Penal nën titull “ Shpërdorimi i detyrës”, parashikon se :
“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve të mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që perben mospermbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjelle atij ose personave të tjere përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë demtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjere juridike, nëse nuk perben veper tjeter penale, denohet me burgim deri në shtatë vjet.”

Nga interpretimi i dispozitave të mesiperme rezultojnë se, ligjvënisi i ka cilësuar si marrëdhënie juridike të rëndësishme, të cilat mbrohen posaçërisht nga legjislacioni penal, marrëdhëniet që kanë të bëjnë me përmbushjen e rregullt të detyrës, zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe urdherave të dala në bazë të ligjit, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve. Në këtë kuptim, kjo është një dispozitë e bardhë e cila i referohet akteve të tjera ligjore e nënligjore, që normojnë punën e personit që ushtron funksione publike. Sa me sipër, për ligjvëniesin cenimi i këtyre marrëdhënieve konsiderohet veprë penale e parashikuar si e tillë nga Neni 248 i K.Penal. Sipas kësaj dispozite, që të ekzistojë vepra penale duhet që :

1. te ekzistojë **objekti i veprës penale**, domethënë te vertetohet thyerja e rregullave të vendosura nga aktet ligjore ose nenligjore, që normojnë detyrat e nepunesit shtetëror apo publik.
2. **nga ana objektive** i pandehuri me veprime aktive, ose mosveprime të kundraligjshme të këtyre sjelle pasojat të rëndësishme në dem të shtetit ose të shtetasve, të cilat konsistojnë në dëm materiale, financiare, apo shkelje të të drejtave themelore të shtetasve (jeta, shëndeti apo pronat e tyre).
3. Gjithashtu, si në çdo veprë penale për të marrë në përgjegjësi personin e dyshuar për këto vepra, duhet patjetër të ekzistojë lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë mes veprimit apo mosveprimit të të pandehurit dhe ardhjes së pasojës kriminale që mund të jetë përfitimi i padrejtë material apo/dhe jomaterial i personave të tretë apo dëmimi i interesave të shtetit, personave të tretë fizike apo juridike.
4. **nga ana subjektive** kjo veprë kryhet me dashje, me qëllim përfitimi material ose jo material, të padrejtë për vetë apo për persona të tjerë.
5. **subjekti i veprës penale** të këtyre mbushur moshën për përgjegjësi penale, pra të jetë mbi 14 vjeç dhe mbi të gjitha duhet të këtyre atribuete dhe aftësi të provuara, për të ushtruar shërbimin publik apo detyrën shtetërore përkatëse.

Gjykata çmon se, i pandehuri Agron Bajraktari, me veprimet e tij, ka konsumuar vepra penale të shpërdorimit të detyrës. Duke vepruar në këto mënyra i pandehuri me dashje të terthortë, ka cenuar mardhëniet juridike të vendosura me ligj ose akte nenligjore, për të siguruar veprimtarinë normale të punës në institucionin ku punonte si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasit ose të shtetit nga veprimet ose mosveprimet kriminale, këto të garantuara në nivel kushtetues dhe të mbrojtura posaçërisht nga legjislativi penal.

Në rastin konkret, i pandehuri Agron Bajraktari sikurse rezultoi edhe nga pamjet filmike të sekuestruara nuk e ka kryer me korrektesë detyrën e tij të rojes, ai ndonëse i ka parë autorët e vjedhjes duke u futur në objekt nuk ka ndermarrë asnjë veprim nga ana e tij për të penguar ata, por qëndron në vendroje pa levizur. Edhe pas kryerjes së vjedhjes autorët largohen pa u shqetesuar nga vendi i ngjarjes ku i pandehuri kryernte detyrën dhe vetëm pasi autorët largohen nga objekti ai leviz nga vendroja/kabina dhe serisht nuk njofton as shërbimin e tij të kompanisë ku është i punësuar dhe as policinë e shtetit.

Në këto rrethana i pandehuri Agron Bajraktari duke moskryer me dashje veprime në kundërshtim me ligjin që përben mospërmbytje të rregullt të detyrës nga ana e tij si punonjës i shërbimit privat të ruajtjes dhe sigurisë publike dhe dëmtuar interesat e ligjshme të personit juridik/subjektit "Blendi" sh.p.k ka konsumuar elementet e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" të parashikuar nga Neni 248 i Kodit Penal.

Kjo dispozitë, si një dispozitë e bardhë (blanket), i referohet akteve të tjera ligjore e nenligjore, që normojnë punën e personit që ushtron funksione publike, për në rastin konkret (Ligji për Policinë e shtetit dhe Kodit Rrugor). Cenimi i këtyre marrëdhënieve konsiderohet veprë penale, e parashikuar nga Neni 248 i Kodit Penal dhe që të ekzistojë objekti i veprës

penale, duhet te vertetohet thyerja e rregullave te vendosura nga aktet ligjore ose nenligjore, qe normojne detyrat e nenpunesit publik. Ne rastin ne gjykim, u vertetua se i padehuri Agron Bajraktari, ne kundershkrim me ligjin nuk ka kryer veprimet procedurale administrative ne dokumentimin e ngjarjes date 10.04.2021 per sa i perket vjedhjes se subjektit tregetar "Blendi" sh.p.k.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit Gjykata ka parasysh :

- Rrezikshmërinë relativisht të lartë shoqërore të veprës penale, e cila ka çënuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj që garantojnë përmbushjen e rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike.
- Rrezikshmerinë relativisht të ulët shoqërore të pandehurit Agron Bajraktari, i cili rezulton i pa dënuar më pare për ndonjë vepër tjetër penale, shkallen e fajit, faktin qe është kryefamiljar i ve dhe me dy femije, faktin që është hetuar pa masë sigurimi personal të karakterit shtrengues, si dhe rrethana te tjera te vleresuara nga gjykata nepermjet bindjes se saj te brendshme, referuar ne teresi akteve te procedimit penal te administruar si prova ne gjykim.

-Po ashtu, Gjykata ne caktimin e masës dhe llojit të dënimit duhet të udhëhiqet nga parimet e Kodit Penal, siç është dhe ai i humanizmit, siç parashikon edhe Neni 1/c i K.Penal.

-Neni 50 parshikon rrethanat rënduese. Në rastin konkret nuk ka asnjë rrethanë rënduese në kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri Agron Bajraktari.

Si përfundim, nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres penale dhe e te pandehurit, Agron Bajraktari, shkalla e fajit, Gjykata konkludon se lloji i dënimit më i përshtatshëm për arsytetuar me sipër, është denimi me burgim siç u kerkua nga organi proceues, por në një më të ulët se ajo e kerkuar nga prokuroria, duke e denuar atë me **nëntë muaj burgim.**

-Meqenese u aplikuan kërkesat e Nenit 406/1 i K.Pr.Penale, të pandehurit Agron Bajraktari i ulet 1/3 e denimit, dhe përfundimisht denohet me **gjashtë muaj burgim.**

Në lidhje me pretendimin e të pandehurit Agron Bajraktari, nëpërmjet mbrojtëse ligjore të tij, per deklarimin e pafajshem dhe pushimin e çështjes, per shkak se nuk ekzistojne elemente per marrjen e personit në përgjegjësi penale dhe ne bazë te Nenit 328/dh, personi nuk e ka kryer vepren penale, Gjykata konkludon se nga aktet e dosjes u provua se i pandehuri Agron Bajraktari me mosveprimet e kundraligjshme, duke **mospërmbushur në mënyrë të rregullt detyrën** sipas Ligjit, nuk ka vlerësuar dhe ka neglizhuar ne lidhje me ngjarjen e ndodhur ne datën 10.04.2021. Pra nga aktet e dosjes u provua lidhja shkaksore e drejtëpërdrejtë mes mosveprimeve te te pandehurit Agron Bajraktari dhe ardhjes se pasojes kriminale ne subjektin tregetar "Blendi" sh.p.k.

Gjykata konkludon se i denuari Agron Bajraktari me qendrimin e tij ne hetim si dhe ne

gjykim, paraqitet si një person ndaj të cilit duhet t'i pezullohet dënimi me burgim, kërkesë kjo e bërë si nga përfaqësuesja e organit të prokurorisë, ashtu edhe mbrojtja e të pandehurit dhe nga vetë i pandehuri.

Bazuar ne Ligjin Nr.36/2017, per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.7895, date 27.01.1995” Kodi Penal i Republikës se Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar Nenit 59 te K.Penal, i cili parashikon se: -“Per shkak te rrezikshmerise se paket te personit, moshes, kushteve shendetesore apo mendore, menyres se jeteses dhe nevojave veçanerisht atyre qe lidhen me familjen, shkollimin ose punen, rrethanave te kryerjes se vepres penale, si dhe te sjelljes pas kryerjes se vepres penale, gjykata kur jep denim me burg deri ne pese vjet, mund te urdheroje qe i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te vihet ne prove, duke pezulluar ekzekutimin e denimit, me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale”.

Ne rastin konkret ne shqyrtim, i pandehuri Agron Bajraktari, paraqet rrezikshmeri te paket shoqerore, pasi rezulton i padenuar me pare për ndonjë vepër tjetër penale, ka treguar bashkëpunim me organet e drejtësisë gjatë hetimit paraprak, ashtu dhe gjatë gjykimit, eshte hetuar pa masë sigurimi personal, pra në gjëndje të lire, moshen e tij madhore, faktin qe eshte kryefamiljar i ve dhe me dy femije, etj.

Pra, është rasti qe gjykata të aplikojë Nenin 59 te Kodit Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim te pavuajtur duke filluar afati i proves nga e nesermja e shpalljes se vendimit te gjykates.

Vënia në provë e të pandehurit Agron Bajraktari për një periudhë kohe **prej një viti**, me kusht që gjate kohes së provës te mos kryejë vepër tjeter penale.

Gjatë kohës së provës, i pandehuri Agron Bajraktari duhet të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë.

Në zbatim të Nenit 60/9 të K.Penal, detyrimin e të pandehurit Agron Bajraktari, duhet që të mos shoqerohet me persona të dënuar.

Po ashtu, Gjykata në referim te Nenin 393/1-2 të K.Pr.Penale, i cili përcakton mënyrën e disponimit të gjykatës mbi “shpenzimet procedurale”, duke nënkuptuar tërësinë e shpenzimeve të parapaguara nga shteti gjatë gjithë proçedimit penal, që nga hetimet paraprake deri në dhënien e vendimit nga gjykata, bazuar dhe në Nenin 485/3 të K.Pr.Penale, i ngarkon të gjitha shpenzimet procedurale të pandehurit Agron Bajraktari.

PER KETO ARSYE,

Gjykata bazuar në Nenet 248, dhe 59/3 të K.Penal, Nenet 379, 384, 390, 406/1 dhe 485 të Kodit të Proçedurës Penale,

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Agron Bajraktari**, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga Neni 248 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me **nëntë muaj burgim**.
2. Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Agron Bajraktari**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet **gjashtë muaj burgim**.
3. Në zbatim të Nenit 59 prg.3 të Kodit Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim duke filluar afati i provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës.
4. Vënia në provë e të pandehurit **Agron Bajraktari**, për një periudhë kohe prej **një viti** me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
5. Gjatë kohës së provës i pandehuri **Agron Bajraktari** të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës që mbulon vëndbanimin e tij.
6. Në zbatim të Nenit 60/9 të K.Penal, detyrimin e të pandehurit **Agron Bajraktari**, që të mos shoqërohet me persona të dënuar.
7. Shpenzimet procedurale hetimore dhe gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi
9. U shpall në Tiranë, sot më datë **06.10.2021**.

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

MARJANA **XHAMALLATI**

KUJTIM VRANIÇI

SHPENZIME GJYQËSORE

| | | |
|--|-----------------------|-------------------|
| Shpenzime të prokurorisë | Në total | 1 000 Lek |
| Masë sigurimi | Nuk ka | 0 Lek |
| Shpenzime në séance paraprake & themel | Njoftime 1 x 150 = | 150 Lek. |
| Shpenzime | Në total | 1 150 Lek. |